

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Drama e Roskovecit"/ Këlliçi: Zegjineja, nën akuzë për veprën penale të moskallëzimit të krimit
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/drama-e-roskovecit-kellici-zegjineja-nen-akuze-per-vepren-penale-te-m-i474260
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:31:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9b701ce6c28e8cf28f59e7d58f07b02a606d2c2661dd038361b787ba81052c9c
TEKSTI	c18e60d7c54b61e760d15bcc15ec05ebf85c08a93ef4841fc6f2ee7390a5b76
PAMJA	feabb8e2c54800d3b0b07722f79fbc58a461b5b2b2a32091ec2d7e7c268a95b2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8eeaec5e33334356220690c0003bee03bcae7e6dc07cce5d9c68afd182ed8f1e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcd39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8eeaec5e33334356220690c0003bee03bcae7e6dc07cce5d9c68afd182ed8f1e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

19:25 Aktualitet

Dëshmia e një 34-vjeçare e cila pretendon se është mbajtur...

"Drama e Roskovecit"/ Këlliçi: Zegjineja, nën akuzë për veprën penale të moskallëzimit të krimit



15 Shtator 2026, 19:25, Aktualitet CNA



Dëshmia e një 34-vjeçare e cila pretendon se është mbajtur me forcë dhe është përdhunuar nga daja i deputetes socialiste Zegjine Çausi ka tronditur opinionin publik.

Në lidhje me rastin dhe dëshmitë e reja të 34-vjeçares ka reaguar nënkryetari i PD-së Belind Këlliçi i cili deklaron se deputetja socialiste sipas dëshmive të 345-vjeçares, ka qenë në

dijeni se daja i saj e ka mbajtur peng one ka abuzuar.

Këlliçi thekson se referuar këtyre detajeve, ndaj deputetes socialiste Zegjine Çaushti duhet të ketë minimalisht një akuzë për moskallëzim krimi.

Sipas Këlliçit, Zegjine Çaushti duhet të japë llogari e të vendoset para ligjit, njëlloj siç do të kishte ndodhur me çdo qytetar tjetër të zakonshëm

“Drama e Roskovecit, Deputetja e PS Zegjineja, nën akuzë për veprën penale të moskallëzimit të krimit!

Dëshmitë e reja të Meritës, viktimës së dhunës dhe marrjes peng në Roskovec nga daja i deputetes socialiste, e rëndojnë shumë pozitën e Zegjinesë. Viktima thotë se ligjvënësja kishte dijeni për krimin.

Sipas saj, Zegjineja kishte shkuar në ditët e para kur ajo mbahej me forcë dhe kishte biseduar me dajën e saj pikërisht për këtë histori. Mirëpo edhe pse mori dijeni, asgjë nuk ndryshoi.

Merita që kishte nevojë për punë për të siguruar ushqim për familjen, u mbajt edhe 40 ditë e më shumë peng pas vizitës së deputetes në banesën e dajës, dhe u abuzua.

Nëse kjo qëndron, nëse kjo dëshmi është e vërtetë, kemi të bëjmë tanimë me një akuzë penale ndaj deputetes së Fierit. Më e pakta, moskallëzim krimi.

Nuk po flasim këtu për përgjegjësi morale dhe për ekspozimin në publik se si ushtrohet dhe shpërdorohet pushteti i saj në Roskovec. Por, për një vepër konkrete penale të parashikuar në Kodin Penal, për të cilën ajo duhet të mbajë përgjegjësi.

Rasti është i rëndë. Të gjithë e dinë se Zegjineja është e preferuara dhe ka mbrojtjen e Ballukut. Të gjithë e dinë se ajo nuk e ka etikën për të dhënë dorëheqjen pas këtij incidenti. Por kupa është derdhur. Dhe ajo duhet të japë llogari e të vendoset para ligjit, njëlloj siç do të kishte ndodhur me çdo qytetar tjetër të zakonshëm!”, shkruan Këlliçi./ CNA





Të sugjeruara

108 ditë proteste/ Qytetarët drejt Kryeministrit

Pse vetëm Erion Veliaj?

U kërcënua me jetë/ Gazetari Stafa tregon mesazhin që iu dërgua

Ngërçi i pagave në sistemin e drejtësisë/ Komisionin i Ligjeve voton me 8 vota pro e 3 kundër propozimin e PS

Krimi i organizuar në Shqipëri/ Zëvendësndihmës Sekretari: Kemi zbuluar struktura të veçanta

Trafiku, "makthi" i qytetarëve që i drejtohen Juglindjes/ Nisin punimet në bypassin e Elbasanit

Gjyqtari Engert Pëllumbi analizon tre situata: Absurde që të mos paguhet gjyqtarët

Miratohet ekstradimi i Ervin Matës drejt Shqipërisë

Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Gjyqtari: Kuvendi po flinte gjumë, Kushtetuesja thotë të zbatohen vendimet e mia

"Protesta është e drejtë e qytetarëve"/ Ambasadori kroat nga Pogradeci: Qeveria duhet të dëgjojë mesazhin

Gjykata e la në qeli/ Avokati i Veliajt në pikë të hallit

Shtyhet sërish Censi i Bujqësisë, ja kur pritet të nisë procesi

"5 viktima në pak javë nga telat e energjisë"/ Këlliçi: Kur do të mbajë përgjegjësi një zyrtar i shtetit

Komunitetet e energjisë së rinovueshme/ ERE përcakton kriteret e regjistrimit dhe monitorimit

Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve/ Nis seanca dëgjimore te Komisioni i Ligjeve

Gjykata e la në qeli; A do të vazhdojë Erion Veliaj të mbajë peng Tiranën?

Pagat e gjyqtarëve/ Gogu te "Ligjet": Kuvendi humbi afatin, por zgjidhja bëhet me ligj

"Kalohen me 99.9% të fondit"/ Debate te Komisioni për Nismat Qytetare për tenderët

Kërkoi lirimin nga qelia/ GJKKO jep vendimin për Metën

Veliaj ngelet në burg/ Protestuesit brohorasin për vendimin ndaj kryebashkiakut
[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM

Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.